



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 110 Prot.

Tiranë, më 01/02/2017

Lënda : Dërgohen rekomandime për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

Drejtuar : **Z. Fatmir XHAFAJ**
Kryetari i Komisionit
Komisioni Për Çeshtjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit !

Në vijim të kërkesës së Komisionit Për Çeshtjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë vijon disa rekomandime në lidhje me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Së pari: Vlerësojmë si shumë pozitive ndryshimet e porozuara nga neni 5, i projektligjit në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, mendojmë se ka vend për përmirësim, duke ofruar mundësi edhe për personat e tjerë që përdorin “mënyra të ndryshme komunikimi”, të tilla si kompjutera ndihmës, programe me zë dhe aparate të tjera teknike.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Së dyti: I njëjti qëndrim vlen edhe për parashikimin që bëhet nga neni 27, i projektligjit, ku parashikohen të drejtat e të pandehurit, duke shtuar pas nenit 34 të Kodit Penal një nen tjetër 34/a. Në lidhje me pikën 1, gërma “b”, të nenit 27, të projektligjit, edhe këtu mendojmë se ka vend që të parashikohet mundësia e mbështetjes së personave që përdorin “mënyra të ndryshme komunikimi”, të tilla si kompjutera ndihmës, programe me zë dhe aparate të tjera teknike.

Gjithashtu, në lidhje me këtë pikë rekomandojmë që **fjala “paaftësi” të zëvendësohet me fjalën “aftësi”**

Së treti: Edhe pse janë marrë këto dy ndryshime në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, nga një analizë e dispozitave dhe propozimeve për ndryshime të Kodit të Procedurës Penale vlerësojmë se ka nevojë për një rishikim të termave të përdorura për personat me aftësi të kufizuara.

Nevoja për përditësimin e gjuhës është një hap i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e shoqërisë për aftësitë e personave me aftësi të kufizuara. Rishikimi dhe përditësimi i terminologjisë vjen edhe si rrjedhojë e detyrimeve që burojnë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, (KDPAK) e cila tashmë është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012. (neni 8 i KDPAK). Pra, termat e përdorur për përkrahimin e personave me aftësi të kufizuara duhet të harmonizohen me KDPAK dhe standartet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Përditësimi i termave duhet të jetë në përputhje me modelin bio-psiko-social që parashikon konventa.

Përveç, përditësimin e termave, detyrime të rëndësishme burojnë nga KDPAK edhe në lidhje me garantimin e aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara (neni 13 KDPAK)

Në bazë të modelit bio-psiko-social të konventës, një nga detyrimet e konventës është edhe vlerësimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara nga komisione multidisiplinare. Një frymë e tillë mungon dhe duhet të përfshihet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Kështu, mund të përmendim:

- nenin 43, 44, 45, 108, 124, 180, 239, 339, të Kodit të Procedurës Penale, termat si “sëmundje mendore”, “gjëndje mendore”, “sëmundje e dukshme mendore”, “i sëmurë mendërisht”, “ç’rregullim mendor”, kanë nevojë të përditësohen dhe përshtaten me



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

modelelet dhe konceptet e KDPAK dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë. “Papërgjegjshmëria për shkak të gjëndjes mendore”, ku terminologjia e përdorur nuk është në përputhje me modelin bio-psiko-social të Konventës;

Në lidhje me përditësimin e termave Ligji “Për shëndetin mendor” mund të shërbejë si një udhëzues i mirë.

- nenin 107, të Kodit të Procedurës Penale, ku përveç terminologjisë problematike dhe në kundërshtim me KDPAK si “shurdh”, “memeç”, “shurdhmemeç”. Kjo dispozitë duhet të rishikohet pasi nënkupton disa kufizime për personat që nuk dëgjojnë, që kanë vështirësi në dëgjim ose kanë aftësi të kufizuara intelektuale, duke kufizuar të drejtën e tyre për trajtim të barabartë përpara ligjit, siç parashikohet nga KDPAK. Dispozita duhet të riformulohet duke marrë parasysh mbrojtjen gjerësisht të të drejtës për të marrë ndihmë në komunikim, për të siguruar akses të barabartë në ligj;
- nenet 155, 156, të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilëve kufizimi i zotësisë për të dëshmuar është shumë i gjerë dhe shumpërfshirës. Duhet të mbahet parasysh detyrimi i KDPAK që rrjedh nga neni 12 i saj. Edhe rishikimi që i është bërë nenit 156, nëpërmjet nenit 91 të projektligjit, vlerësojmë se nuk është në përputhje me standartet për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Neni 239, 264, të Kodit të Procedurës Penale, janë nene që kanë nevojë të rishikohen pasi mungon karakteri multidisiplinar dhe nuk theksojnë faktin se në qëndër të vëmendjes duhet të jetë interesi më i mirë i personit;
- neni 339 i K.Pr.Penale të Kodit të Procedurës Penale i cili përjashton personat me aftësi të kufizuara intelektuale nga seancat dëgjimore, bie në kundërshtim me të drejtën për akses të barabartë në drejtësi, të parashikuar nga Konventa;

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,



KOMISIONERE

Irma BARAKU



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al